REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA GJIROKASTËR**

**KËSHILLI BASHKIAK**

**P/VENDIM**

**NR _____, DATË ___________**

**"PËR MIRATIMIN NË PARIM APLIKIMIN PËR PROJEKTIN DESTIN – STRATEGIC CALL PROGRAM: 629, PRIORITIES:3 CALL CODE: 5 TH GR-AL 4.6.1 (NO : 22827)"**

Në zbatim të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar, ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, ligjit nr 68, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", udhëzimit nr 09. datë 23.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" të ndryshuar, si dhe në mbështetje të VKB-së nr 101, datë 22.12.2025 "Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 dhe buxhetit vjetor 2026" të ndryshuar, ju vendosim në dispozicion dokumentin "Për shtesa dhe ndryshime në vendimin nr 101, datë 22.12.2025 "Për miratimin e programit afatmesëm 2026-2028 dhe buxhetit vjetor 2026".

**V E N D O S I:**

- Të miratojë në parim aplikimin per projektin "DESTIN – Strategic Call, Program: 629, Priorities: 3, Call Code: 5th gr-AL 4.6.1 (No.: 22827)".
- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet ekzekutivi.
- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETARI I KËSHILLIT**

**Merita Isaraj**

**Sekretar i Këshillit**

**Bexhet Baxhella**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA GJIROKASTËR**
**KËSHILLI BASHKIAK**

**P/VENDIM**

**NR _____, DATË ____________**

**"Për transferimin e fondeve për projektin "CROSS", "CERV", "ECOBASE", dhe "CHERRY""**

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e datës _________________ pasi shqyrtoi materialin e paraqitur **"Për transferimin e fondeve për projektin "CROSS", "CERV", "ECOBASE", dhe "CHERRY".** Në zbatim të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjit nr.9936 dt.26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, ligjit nr.10296, datë 8.7.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" i ndryshuar, ligjit 68/2017 "Për fianancat e vetëqeverisjes vendore", Udhëzimit nr 09. datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 10, datë 12.07.2024 "Për rregjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare, si dhe VKB nr.101 datë 22.12.2025 "Për Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 dhe Buxhetit vjetor 2026", .

**V E N D O S I**

1. Të miratojë transfrimin e mëposhtme;

**Bëhet:**

1. Gr.00 Tit. AC115 Kap.2 Art 602 me kod projekti P822ABM "CROSS" në vlerën 3 249 118 ALL pa TVSH
2. Gr.00 Tit. AA115 Kap.2 Art 602 me kod projekti P413AAN "CERV" në vlerën 912 024.75 ALL pa TVSH
3. Gr.00 Tit. AA115 Kap.2 Art 602 me kod projekti P563AAB "ECOBASE" në vlerën 22 502.60 ALL pa TVSH
4. Gr.00 Tit. AC115 Kap.2 Art 602 me kod projekti P476AAC "CHERRY" në vlerën 637 954.39 ALL pa TVSH

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet ekzekutivi.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETARI I KËSHILLIT**

**Merita Isaraj**

**Sekretar i Këshillit**

**Bexhet Baxhella**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI

# P/VENDIM

Nr.__ date ___.___.2026.

**PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË BASHKISË PËR FAMILJET QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE PËR MUAJIN KORRIK 01-31.07.2026.**

Në bazë të Ligjit nr. 57/2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë", VKM nr.597 datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike, përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", vendimit Nr 85 datë 10.02.2021, si dhe bazuar në Udhëzimi nr.4 datë 17.02.2017 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, pika 7, Ligjit nr. 139/2015 " Për VetëqeverisjenVendore", Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", Ligjit 68/2017 "Mbi Financat e Vetëqeverisjes Vendore" VKB nr. 101 datë, 22.12.2025 për "Për Miratimin Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 dhe Buxhetit Vjetor 2026" është miratuar fond "Ndihma Ekonomike" me fond limit 3.000.000 lekë/vit, Këshilli i Bashkisë Gjirokastër;

## VENDOSI:

1. Të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin **Koreik 2026, 50 individë/ familje** me **fond 146,149 lekë.**
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Agjencia e Shërbimeve Sociale dhe Shëndetësore, (Sektori i Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimeve Shoqërore), si dhe Drejtoria e Financës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I KËSHILLIT**
**Merita Isaraj**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA GJIROKASTËR

KËSHILLI

P/ VENDIM

Nr.___ datë ___.___.2026

**PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR PËRDORIMI E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLLOK- NDIHMËN EKONOMIKE DERI NE 6% PËR MUAJIN KORRIK 01-31.07.2026.**

Në bazë të Ligjit nr. 57/2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë", VKM nr.597, date 04.09.2019 për "Për Përcaktimin e Procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike, përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", Këshilli i Bashkisë Gjirokastër, me propozim të kryetarit të bashkisë Gjirokastër;

**VENDOSI:**

1. Të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin **Korrik 2026, 6 (gjashtë), individë/ familje** me fond **19,957 lekë.**
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Agjencia e Shërbimeve Sociale dhe Shëndetësore, (Sektori i Ndihmës Ekonomike dhe Paaftësisë), si dhe Drejtoria e Financës.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR I KËSHILLIT**
**Merita Isaraj**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA GJIROKASTËR**
**KËSHILLI BASHKIAK**

**P/VENDIM**

**NR _____, DATË ____________**

**"PËR SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR 101, DATË 22.12.2025 "PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT AFATMESËM 2026-2028 DHE BUXHETIT VJETOR 2026"**

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e datës ________________ pasi shqyrtoi materialin e paraqitur **"Për shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr 101, datë 22.12.2025 "Për miratimin e programit afatmesëm 2026-2028 dhe buxhetit vjetor 2026,** në zbatim të ligjit 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" të ndryshuar, ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, ligjit nr 68, datë 27.04.2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", udhëzimit nr 09. datë 23.03.2018 "Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit" të ndryshuar, si dhe në mbështetje të VKB-së nr 101, datë 22.12.2025 "Për Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 dhe Buxhetit Vjetor 2026" të ndryshuar.

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë shtesën në Vendimin nr. 101, datë 22.12.2025, nga fondet e trashëguara të pashpërndara, kapitulli 01, si më poshtë;

   a) Programi AF115, Projekti P912XXX "Rikonstruksion i objektit ekzistues të shkollës 9-vjeçare "Andon Zako Çajupi", godina e re e kalçetos, ndërtimi i ashensorit si dhe muri i ri rrethues", Artik.231, në vlerën 2,380,000 lekë.

   b) Programi AF115, Projekti P912XXX Mbikqyrje e objektit "Rikonstruksion i objektit ekzistues të shkollës 9-vjeçare "Andon Zako Çajupi", godina e re e kalçetos, ndërtimi i ashensorit si dhe muri i ri rrethues", Artik. 231, në vlerën 2,280,000 lekë.

   c) Programi AA115, Projekti P614AAA Plan i Detajuar Vendor Njësia Strukturore: ZE.3.1 Artik. 230, në vlerën 668,763 lekë

   d) Programi AA115, Projekti P614AAA Plan i Detajuar Vendor Njësia Strukturore: ZU.12 Artik. 230, në vlerën 668,763 lekë

   e) Programi AA115, Projekti P614AAA Plan i Detajuar Vendor Njësia Strukturore: ZU.5.1. A. Artik. 230, në vlerën 62,473 lekë

   f) Programi AE115, Produkti V510AAB, Artik. 602, Aktiviteti "ujë" në vlerën 121,715 lekë

   g) Programi AA115 Produkti V111AAD Artik. 602, Aktiviteti "Shërbimi i hostimit në Icloud" në vlerën 118,000 lekë

   h) Programi AA115, Produkti V111AAD, Artik. 602, Aktiviteti "Pagesa për ekzekutimin e vendimit nr ISHPSHSH-GJ-2026-000176", në vlerën 800,000 lekë

i) Programi AA115, Produkti V111AAD, Artik.231, Aktiviteti "Mobilim ambienti, rafte" në vlerën 600,000 lekë.

j) Programi AA115, Produkti V111AAD, Artik.602, Aktiviteti "Materiale IT" në vlerën 120,000 lekë.

2. Të miratojë ndryshimet në vendimin nr 101, datë 22.12.2025 si më poshtë;
   Pakësohet
   Programi AA115, Projekti P614AAA Plan i Detajuar Vendor Njësia Strukturore: ZE.3.2. A. Artik. 230, në vlerën 603,290 lekë
   Shtohet
   Programi AA115, Projekti P614AAA Plan i Detajuar Vendor Njësia Strukturore: ZU.5.1. A. Artik. 230, në vlerën 603,290 lekë
3. Të miratojë burimin e financimit për diferencat e objekteve sipas përcaktimit të pikës 1, shkronja a, c, d dhe e, të këtij vendimi, në vitin 2027 sipas Programit Buxhetor Afatmesëm 2027-2029.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet ekzekutivi.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETARI I KËSHILLIT**

**Merita Isaraj**

**Sekretar i Këshillit**

**Bexhet Baxhella**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA GJIROKASTËR**

Nr.________prot. Gjirokastër, më ___.___.2026

**P/V E N D I M**

**Nr ______ , date ______________**

**"PER MARRJEN E NISMES**

**PER HARTIMIM PLANIT TE DETAJUAR VENDOR ( P.D.V) PER NJESINE STRUKTURORE Z.E.3.2."**

Ne zbatim te ligjit nr 139/2015 " Per veteqeverisjen vendore " si dhe ne Ligjin Nr 117/2014 Per Planifikimin dhe zhvillimin e territorit , pika 1 shkronja b te nenit 13 dhe nenin 65 (Nisma per hartimin e PDV) te VKM Nr 671 , date 29.7.2015 " Per miratimin e rregullores per planifikimin e territorit "

**V E N D O S A :**

**PER MARRJEN E NISMES PER HARTIMIN E PLANIT TE DETJAUAR VENDOR (PDV) PER NJESINE STRUKTURORE Z.E.3.2.**

Mbeshtetur ne Vendimin Nr 1 , date 08.02.2017 te Keshillit Kombetar te Territorit " Per miratimin e Planit te Pergjithshem Vendor " ku jane percaktuar zonat te cilat kerkojne hartimin e PDV, marrim nismen per hartimin e P.D.V per Njesine Strukturore Z.E.3.2.

Hartimi i Planeve te Detajuara Vendore (PDV) do te krijoje mundesine per te lehtesuar procedurat e zhvillimit dhe ndertimit te disiplinur ne zone.

Per hartimin e nismes per hartimin e PDV-ve po plotesojme hapat e kerkuara sipas ligjit.

**I. Analiza**

Njesite strukturore per te cilat marim kete nisme jane te perfshira ne Zonat ekonomike (ZE) te percaktuara per zhvillim industrial me ndotje te ulet e mesatare te mjedisit dhe aktivitete te tjera ekonomike e sherbimesh.

Vlen te theksohet se PPV i Bashkise Gjirokaster ne keto zona i ka perjashtuar totalisht funksionet e banimit ne keto njesi.

Strategjia e P.P.V i ka vendosur keto njesi strukturore ne zonat me perparesi per hartimin e Planeve te Detajuara Vendore (PDV) , kryesisht per arsye te tendencave te zhvillimit qe paraqesin si dhe per shkak te vendndodhjes se tyre ne sistemin e pergjithshem urban te qytetit te Gjirokastres.

Ne baze te percaktimeve te pikes 3 , te nenit 22 te ligjit 107/2014 "Per planifikimin e zhvillimin e territorit" , Njesite strukturore me siper jane zona qe kane nevoje:

- Per zhvillimin e zones.
- Per ndertimin e infrastrukturave publike.

**Per zhvillimin e zones**

Njesite strukturore me siper shtrihen ne veri te qytetit ne te dy anet e rruges nacionale (SH 4) Gjirokaster –Tepelene ne nje distance prej jo me shume se 3 km nga qyteti , shtrihen ne siperfaqe relativisht te sheshte dhe sipas percaktimeve te PPV , jane Zona per sherbime urbane me percaktim si me poshte:

Zona : Zone Ekonomike (ZE)

Sistemi i territorit : Sistem Urban (UB)

Zonimi i perdorimit miks te tokes : Aktivitete prodhuese me shqetesim te ulet ne mjedis (1.1).

Kategorite e perdorimit te tokes: Industri dhe ekonomi (IE), Sherbime (S) , Infrastruktura teknike (IN).

Para miratimit te PPV ishin siperfaqe me emertim pasurie pemetore, por ne keto zona ishin dhene edhe leje ndertimi me ndertime te karakterit ekonomik prej vitit 1995 dhe deri ne vitin 2011 . Me miratimin e PPV, keto zona kane nevoje per zhvillim , pasi ndertimet ekzistuese jane ndertime qe kane nevoje per zgjerim , por edhe biznese te tjera te cilet kane shprehur interesa per zhvillim. Aktualisht jane zonat per te cilat ka shprehje interesi nga biznesi ne Gjirokaster.

**Per ndertimin e infrastrukturave publike**

Njesite strukturore per te cilat marim kete nisme pavaresisht se shtrihen ne ane te rruges nacionale SH 4 . Ne brendesi te tyre nuk kane asnje nga elementet baze te infrastrukturave publike. Bisneset qe kryejne aktivitet prej vitesh ne keto zona , pervec rrjetit elektrik dhe

furnizimit me uje qe e kane bere ne menyre individuale pa ndonje studim te vecante ,rrjetet e tjera nuk ekzistojne si ai i kanalizimeve te ujrave te zeza dhe atyre te bardha. Ne kete zone operohet me gropa septike .

Ne keto njesi do te hartohen akset kryesore te rrugeve , hyrje daljet nga rruga nacionale dhe elementet kryesore te infrastruktures nentokesore. Keto njesi strukturore kane te perbashket disa vecori te cilat e bejne te lehte ndertimin e infrastrukturave publike. Parcelat jane te lidhura me njera tjetren , jane siperfaqe te rafsheta dhe madhesite e parcelave sipas titujve te pronesise jane relativisht te medha mbi 2000 m2. Nje pjese e pronesise figuron pasuri shtet.

## II. Po paraqesim Kufijte e Njesise si me poshte :

**Kjo njësi ka sipërfaqe prej S=5.246 ha (52,463.25 m²).**

**Njësia ka kufij duke filluar nga jugu sipas pikave me koordinata si më poshtë:**

| | KOORDINATAT KRGJSH | |
|---|---|---|
| | E | N |
| P1 | 512322.94 | 4438861.55 |
| P2 | 512356.96 | 4438892.21 |
| P3 | 512389.3 | 4438937.85 |
| P4 | 512387.34 | 4438953.53 |
| P5 | 512349.83 | 4439040.69 |
| P6 | 512319.73 | 4439087.17 |
| P7 | 512297.89 | 4439110.41 |
| P8 | 512264.29 | 4439135.75 |
| P9 | 512252.81 | 4439130.01 |
| P10 | 512219.91 | 4439169.35 |
| P11 | 512123.59 | 4439246.77 |
| P12 | 512062.72 | 4439325.66 |
| P13 | 512045.06 | 4439359.14 |
| P14 | 511967.5 | 4439453.36 |
| P15 | 511908.7 | 4439389.94 |
| P16 | 512027.68 | 4439273.51 |
| P17 | 512098.9 | 4439205.93 |
| P18 | 512190.74 | 4439127.81 |
| P19 | 512218.88 | 4439074.89 |
| P20 | 512220.69 | 4439019.76 |

**R E P U B L I K A  E  S H Q I P Ë R I S Ë**
**BASHKIA GJIROKASTËR**
**KËSHILLI I BASHKISË**

**P/V E N D I M**

Nr._____ Datë ____.____.2026

**" PËR KRIJIMIN E KËSHILLIT VENDOR TË SIGURISË PUBLIKE NË BASHKINË GJIROKASTËR DHE MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E TIJ "**

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligjit nr.107/2016, "Për Prefektin e Qarkut" i ndryshuar, Ligjit nr. 108/2014, "Për Policinë e Shtetit" i ndryshuar, Ligjit Nr.103/2014 "Për miratimin e strategjisë së sigurisë kombëtare të Republikës së Shqipërisë", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 678, datë 30.10.2024 "Për përbërjen, rregullat më të hollësishme të organizimit dhe funksionimit të këshillave vendorë të sigurisë publike dhe këshillit kombëtar për sigurinë në komunitet", Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizimit të Dhunshëm dhe Plani i Veprimit, Akteve Ndërkombëtare si: Deklarata Universale e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, shkresës së Prefektit Gjirokastër Nr.1006 Prot., datë 17.12.2024, protokolluar me tonën Nr.11482 Prot., datë 17.12.2024 si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Prokurimeve Publike, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës ___/___/2026 :

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e krijimit të Këshillit Vendor të Sigurisë Publike në Bashkinë Gjirokastër dhe rregullores për organizimin dhe funksionimin e tij, që i bashkëngjitet këtij vendimi.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi administrata e Bashkisë Gjirokastër.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar.

**SEKRETAR I KËSHILLIT**
**Bexhet Baxhella**

**KRYETAR I KËSHILLIT**
**Merita Isaraj**

Adresa: Sheshi "Çerçiz Topulli", Gjirokastër, Shqipëri. Tel: ++355 84 26 4103/26 2424/ 26 3500. Fax: ++355 84 26 3796

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA GJIROKASTËR**

**KËSHILLI BASHKIAK**

**P/VENDIM**

**NR _____, DATË ____________**

**"PËR NJË NDRYSHIM NË PLANIN E MENAXHIMIT TË TRANSPORTIT PUBLIK TË VIZITORËVE TË HUAJ DHE VENDAS NË BASHKINË GJIROKASTËR, MIRATUAR ME VKB-NË NR.63, DATË 02.09.2025"**

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e datës _______________ pasi shqyrtoi materialin e paraqitur **"Për Një Ndryshim në Planin e Menaxhimit të Transportit Publik të Vizitorëve të Huaj dhe Vendas në Bashkinë Gjirokastër, miratuar me VKB-në nr.63, datë 02.09.2025."**. Ligji nr. 139/2015 dt. 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, neni 9, pika 1.1, shkronja a, b,c, pika 1.2, neni 22, neni 23, pika 6, neni 28, pika1, 4, neni 32, neni 33, pika 1, shkronja a, pika 2. Ligji nr. 8308, dt. 18.3.1998 "Për transportet rrugore" (ndryshuar me ligjet nr. 8908, dt. 6.6.2002; nr. 9096, dt. 3.7.2003; nr. 9373, dt. 14.4.2005; nr. 9760, dt. 21.6.2007; nr. 10137, dt. 11.5.2009; nr. 10 302, dt. 15.7.2010; nr. 118, dt. 13.12.2012; nr. 21, dt. 14.2.2013; nr. 37, dt. 10.4.2014; nr. 10/2016, dt. 11.2.2016), Vendimi Nr. 85, Datë 8.2.2017 Për Përcaktimin e Rregullave për Prodhimin, Shpërndarjen dhe Pajisjen e Udhëtarëve me Bileta Transporti Rrugor (Ndryshuar me Vkm Nr. 224, Datë 13.4.2022).

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë ndryshimet në planin e menaxhimit të transportit publik të vizitorëve të huaj dhe vendas në bashkinë Gjirokastër sipas dokumentit bashkëngjitur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet ekzekutivi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETARI I KËSHILLIT**

**Merita Isaraj**

**Sekretar i Këshillit**

**Bexhet Baxhella**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

# BASHKIA GJIROKASTËR

## KËSHILLI BASHKIAK

## P/VENDIM

## NR _____, DATË ____._____.2026

## "PËR NJË SHTESË NË VKB-NË NR. 101 DATË 22.12.2025 "PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2026-2028 DHE BUXHETIT VJETOR 2026"

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e datës ____.______.______ pasi shqyrtoi materialin e paraqitur "Për një shtesë në VKB-në nr. 101 datë 22.12.2025 "Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 dhe buxhetit vjetor 2026", në zbatim të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjit nr.9936 dt.26.06.2008"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, ligjit nr.10296, datë 8.7.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" i ndryshuar, ligjit 68/2017 "Për fianancat e vetëqeverisjes vendore", Udhëzimit nr 09. datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", Kontratës së Sponsorizimit Nr 12516 prot, datë 02.12.2025, midis Bashkisë Gjirokastër dhe Raiffeisen Invest sh.a', si dhe VKB Nr 101 datë 22.12.2025 "Për nje shtesë në VKB-në nr.101 datë 22.12.2025 "Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 dhe buxhetit vjetor 2026", Kontratës së Bashkëpunimit për Sponsorizim Nr 7090 prot, datë 01.07.2026, midis Bashkisë Gjirokastër dhe ALFA sh.a', si dhe VKB Nr 101 datë 22.12.2025 "Për nje shtesë në VKB-në nr.101 datë 22.12.2025 "Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 dhe buxhetit vjetor 2026".

## V E N D O S I:

1. Të miratojë shtesën si më poshtë:
   - Programi AC115 Kap.5 Art 602 me kod projekti V813AAB në vlerën 300,000 lekë.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet ekzekutivi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETARI I KËSHILLIT**

**Merita Isaraj**

**Sekretari i Këshillit**

**Bexhet Baxhella**

Adresa: Sheshi "ÇerçizTopulli", Nd.4, H.1, Gjirokaster, Shqiperi. Tel: ++355 84 26 4103/26 2424/ 26 3500. Fax: ++355 84 26 3796

Distancat midis pikave janë:

| SEGMENTI | DISTANCA (m) |
|---|---|
| P1-P2 | 45.8 |
| P2-P3 | 55.94 |
| P3-P4 | 15.8 |
| P4-P5 | 94.89 |
| P5-P6 | 55.38 |
| P6-P7 | 31.89 |
| P7-P8 | 42.08 |
| P8-P9 | 12.84 |
| P9-P10 | 51.28 |
| P10-P11 | 123.58 |
| P11-P12 | 99.64 |
| P12-P13 | 37.85 |
| P13-P14 | 122.04 |
| P14-P15 | 86.48 |
| P15-P16 | 166.47 |
| P16-P17 | 98.18 |
| P17-P18 | 120.57 |
| P18-P19 | 59.94 |
| P19-P20 | 55.16 |
| P20-P1 | 188.38 |

Perimetri i njësisë strukturore është P = 1,564.18 m.

**Sipërfaqja e njësisë strukturore është S = 5.246 ha (52,463.25 m²).**

Kufiri i njësisë strukturore **ZE.3.2** është paraqitur në hartën bashkëngjitur këtij dokumenti dhe përbën territorin objekt të hartimit të Planit të Detajuar Vendor.




*Fig.1 Kufiri i njësisë strukturore **ZE.3.2***

## III. Kodi i njesive

Kodi i njesive per te cilat hartohet nisma eshte Z.E.3.2.

## IV. Lista e parcelave

Njesia strukturore Z.E.3.2 perbehet prej 42 (dyzete e dy) parcela.

| Nr rend | Zona kadastrale | Nr pasurise | Pronari | Siperfaqja | Lloji i pasurisë |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 8541 | 198/8 | Fillo Sofo Ciko | 2000 | Pemetore |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 2 | 8541 | 198/9 | Flamur Barjam Bajo etj. | 1000 | Pemetore |
| 3 | 8541 | 198/10 | Jorgji Vasil Kuro etj. | 265 | Pemtore |
| 4 | 8541 | 198/11 | Petro Vasil Kuro | 2735 | Truall |
| 5 | 8541 | 199/6 | Stavri Dhimiter Mandili etj. | 1000 | Pemetore |
| 6 | 8541 | 199/7 | Stavri Dhimiter Mandili | 1250 | Pemtore +Truall |
| 7 | 8541 | 199/8 | Zeqo Beqo Nora | 400 | Pemetore |
| 8 | 8541 | 199/9 | Arqile Zharkalli etj. | 2117 | Pemetore +truall |
| 9 | 8541 | 199/10 | Kastriot Fuat Bajaj | 1000 | Pemetore |
| 10 | 8541 | 199/11 | Luan Beqo Nora | 750 | Pemetore |
| 11 | 8541 | 199/12 | Altin Xhuka etj. | 2850 | Pemetore |
| 12 | 8541 | 199/14 | Luan Beqo Nora | 450 | Pemtore |
| 13 | 8541 | 199/15 | Zeqo Beqo Nora | 350 | Pemetore |
| 14 | 8541 | 5/15 | Qirjako Gaqe Dhima | 180 | Truall |
| 15 | 8541 | 5/15-ND | Qirjako Gaqe Dhima | 185 | Ndertese |
| 16 | 8541 | 5/17 | Afron Nazif Bime | 54 | Truall |
| 17 | 8541 | 5/18 | K.A.SHPK Gjirokaster | 1361 | Truall |
| 18 | 8541 | 5/20 | Eriselda Jonuz Rabaj | 866 | Truall |
| 19 | 8541 | 5/25 | Agron Najzi Bimi etj. | 612 | Truall |
| 20 | 8541 | 5/26 | Jorgji Ilia Kondi | 384 | Truall |
| 21 | 8541 | 5/29 | Shoqeria EIDA Sh.p.k. | 882 | Truall |
| 22 | 8541 | 5/30 | Arben Stefan Gushi | 1142 | Truall |
| 23 | 8541 | 5/32 | AGNA Grup | 10261 | Truall |
| 24 | 8541 | 5/33 | Xhevaire Rexhep Ribaj | 500 | Truall |
| 25 | 8541 | 5/40 | Muevete Duro Bime | 410 | Truall |
| 26 | 8541 | 5/224 | Shtet | 638 | Shesh |
| 27 | 8541 | 5/223 | Shtet | 1066 | Rruge |
| 28 | 8541 | 5/225 | Shtet | 2777 | Shesh |
| 29 | 8541 | 5/226 | Shtet | 703 | Shesh |
| 30 | 8541 | 6/320 | Shteti | 43 | Shesh |
| 31 | 8541 | 199/20 | Guximtar Laze Muho | 50 | Truall |
| 32 | 8541 | 199/19 | Guximtar Laze Muho | 200 | Truall |
| 33 | 8541 | 199/17 | Zeqo Beqo Nora | 250 | Truall |
| 34 | 8541 | 199/16 | Zeqo Beqo Nora | 400 | Truall |
| 35 | 8541 | 6/337 | Shtet | 986 | Truall |
| 36 | 8541 | 6/335 | Shtet | 564 | Truall |
| 37 | 8541 | 5/39 | Vangjel Vasil Ksera | 3000 | Truall |
| 38 | 8541 | 6/56 | Gjergji Fuat Bajo | 398 | Godine |
| 39 | 8541 | 199/28 | Shtet | 1565 | Truall |
| 40 | 8541 | 5/221 | Shtet | 52 | Truall |
| 41 | 8541 | 5/229 | Shtet | 1925 | Shesh |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 42 | 8541 | 5/220 | Shtet | 261 | Truall |

## V. Plan i veprimeve per hartimin e PDV

Per hartimin e PDV-ve do te ndermerren keto hapa :

- Mbledhje informacioni , si te gjendjes se pronesise, topografike , demografike , ndertime me leje ose pa leje ne zone.
- Percaktimi i grupit te eksperteve qe do te hartojne PDV (pas procesit te tenderimit)..
- Percaktimi i afateve kohore per hartimin e PDV nga grupi eksperteve , perjashto afatet kohore qe duhen per takimet publike.
- Miratimi i PDV nga Kryetari i Bashkise , pasi jane ndjekur procedurat si takime publike , shqyrtimi i dokumentit te PDV nga struktura pergjegjese e Urbanistikes ne Bashki , rishikime dhe permiresime te dokumentit te PDV ne se ka.
- Njoftimin e Keshillit te Bashkise per miratimin e PDV nga Kryetari i Bashkise dhe kerkesen per konformitetin e procedures.
- Vendimin e konformitetit te Keshillit te Bashkise per procedure e hartimit te PDV .

## VI. Lista e dokumentave perberes se PDV

Dokumenti i PDV bazohet ne dokumentin e miratuar te PPV dhe legjislacionin ne fuqi dhe duhet te permbaje dokumentat si me poshte:

- Dokumentin e analizes per njesine.
- Strategjine e zhvillimit te njesise.
- Propozimin me percaktime territoriale
- Rregulloren e PDV
- Vleresimin ekonomik e financiar per zbatimin e PDV
- Hartat qe shoqerojne dhe pasqyrojne permbajtjen e seciles prej pikave me siper. Shkallet e hartave varojne nga 1: 500 deri ne 1:2000 ne perputhje me madhesine e zones.
- Relacionin propozimeve te PDV.
- Studimi e vleresimit te ndikimit nga zhvillimi dhe ndikimit ne mjedis i cili duhet te jete ne perputhje me studimin e Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis (VSM) te Bashkise Gjirokaster.
- Planin e veprimeve dhe investimeve per zbatimin e PDV.
- Indikatoret per monitorimin e zbatimin e PDV.

## VII. Ekspertet (fusha e e ekspertizes) qe do hartojne PDV

Per hartimin e PDV-ve ekspertet qe punojne jane te fushave te ndryshme .

- Planifikues urbane (Urbaniste)
- Topografe
- Inxhinjere ndertimi te drejtimit infrastrukture rrugore.
- Inxhinjere hidroteknike
- Inxhinjere elektrike
- Inxhinjere gjeologe
- Inxhinjere mjedisi

## VIII. Percaktime per procesin e bashkrendimit keshillimit dhe takimeve publike dhe afatet perkatese

Mbeshtetur ne nenet 66 dhe 67 te VKM 671 "Per miratimin e rregullores se Planifikimit te territorit " Autoriteti pergjegjes siguron nje proces dialogu , bashkepunimi dhe bashkerendimi me te gjitha autoritetet e planifikimit , palet e interesit etj . Gjithashtu behet edhe keshillimi dhe takimi publik ne kuader te hartimit te PDV. Konkretisht do te behen dy keshillime dhe takime publike sipas fazave qe do ti paraqesim me poshte:

a. Me perfundimin e analizes se gjendjes ekzistuese.

Analiza e gjendjes ekzistuese do te kryhet nga ekspertet qe do te hartojne PDV (studjo qe do te fitojne ne procesin e tenderimit) dhe me mbeshtetje te Drejtorise se Planifikimit te Territorit ne Bashki.
Analiza e gjendjes ekzistuese do te kerkoje nje periudhe 2 deri 3 mujore.

b. Me perfundimin e projektaktit te PDV –se hartuar nga ekspertet qe do te hartojne PVD.

Kjo faze do te kerkoje perseri nje periudhe kohore prej 2 deri 3 muaj.

Per cdo takim nga ana jone do te njoftojme palet e interesuara , pronaret e trojeve , specialist te fushave te ndryshme etj , 20 dite para cdo takimi nepermjet njoftimeve ne mjetet e informacionit publik , rrjete sociale etj. Per cdo verejtje apo propozim qe do te dali gjate takimeve nga ana jone do te permblidhen dhe do te botohen ne Regjistrin e Integruar te Territorit (RIT) dhe ne nje ose disa mjete te informimit publik. Projektakti i rishikuar mund te kerkoje nje takim te trete publik dhe botohet ne RIT.

## IX. Buxheti per hartimin PDV

Bashkia ka percaktuar ne buxhetin e saj fonde per hartimin e PDV-ve . Per njesine strukturore objekt i kesaj nisme eshte percaktuar nje fond prej 896.710 leke me TVSH.

Mbeshtetur sa me siper marim nismen per miratimin e PDV –ve ne Njesine strukturore Z.E.3.2.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË GJIROKASTËR

# P/VENDIM

Nr. ____, datë ____/____/2026

## PËR
## "MIRATIMIN E SIPËRFAQEVE TË FONDIT PYJOR DHE KULLOSOR NË PRONËSI TË BASHKISË GJIROKASTËR QË DO TË JEPEN NË PËRDORIM / QIRA PËR ZHVILLIMIN E AKTIVITETEVE EKONOMIKE, PEMËTARISË, BLEGTORISË DHE AGROTURIZMIT"

Në mbështetje të nenit 9, të nenit 54, nenit 55 dhe nenit 64 të Ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", të ndryshuar; të Ligjit nr.57/2020 "Për Pyjet"; të Ligjit Nr.93/2015 "Për turizmin", të Ligjit nr.9693, datë 19.03.2007 "Për fondin kullosor", të ndryshuar; të VKM Nr.559, datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/ përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për përdorimet drusore dhe jodrusore pyjore" , të Ligjit Nr.9874, datë 14.08.2008 "Për Ankandin Publik" i ndryshuar neni 13, si dhe të Udhëzimit nr.1, datë 09.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik"; pasi shqyrtoi relacionin dhe raportin teknik të Agjencisë së Bujqësisë, Pyjeve, Ujitjes dhe Kullimit në mbledhjen e datës 30 / 07/2026;

## VENDOSI:

**1.**Të miratojë listën e sipërfaqeve të fondit pyjor dhe kullosor publik, në pronësi të Bashkisë Gjirokastër, për tu dhënë me qira/përdorim , për zhvillimin e aktiviteteve të agroturizmit, sipas raportit teknik të Agjencisë të Bujqësisë, pyjeve, Ujitjes dhe Kullimit bashkëlidhur këtij vendimi.

**2.**Të miratojë për vijimin e procedurave të dhënies me qira të pasurive:

| Nr. | Pasuria | Z.K | Lloji | Sipërfaqja |
|---|---|---|---|---|
| 1 | 871 | 2277 | Kullotë | 437 289 m² |
| 2 | 873 | 2277 | Kullotë | 729 657 m² |
| 3 | 881 | 3114 | Kullotë | 418 358 m² |

Adresa: Sheshi "Çerçiz Topulli", Gjirokastër, Shqipëri. Tel: ++355 84 26 4103/26 2424/ 26 3500. Fax: ++355 84 26 3796

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 4 | 883 | 2277 | Pyll | 251 341 m² |

me sipërfaqe totale 1 585 304 m², sipas të dhënave të raportit teknik.

**3.**Ngarkohet aparati i Bashkisë Gjirokastër për zbatimin e këtij vendimi.

**4.**Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të Ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore"

**SEKRETAR I KËSHILLIT**

**Bexhet Baxhella**

**KRYETARI I KËSHILLIT**

**Merita Isaraj**